



V E N D I M

K.P.P.710/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alb Korça 2002” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-73808-06-06-2018 me objekt “*Mirembajtje Rutine E Dimerore Me Performance Rruga Libonik-Lozhan-Grabove + Rruga Lin-Pogradec + Rruga Voskop-Voskopoje 72 Km*” me fond limit 40,030,784 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.

Ankimues: “Alb Korça 2002” shpk
Rruga nacionale Korçë-Bilisht pranë nën/stacionit Zemblak

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër
Ish Zona Industriale Gjirokaster

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e*

Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 06.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-73808-06-06-2018 me objekt “*Mirembajtje Rutine E Dimerore Me Performance Rruga Libonik-Lozhan-Grabove + Rruga Lin-Pogradec + Rruga Voskop-Voskopoje 72 Km*” me fond limit 40,030,784 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.

II.2. Në datën 09.07.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 25.07.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Rej	pa ofertë	I skualifikuar
- Adem Pojani	pa ofertë	I skualifikuar
- Simaku	pa ofertë	I skualifikuar
- Vashtëmia	pa ofertë	I skualifikuar
- Alb Korça 2002	32,724,900	I skualifikuar
- 2T	38,029,244.80	I kualifikuar
- Al Dok	38,553,440	I kualifikuar

II.4. Në datën 25.07.2018 operatori ekonomik “Alb Korça 2002” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. *Operatori ekonomik Alb Korca 2002, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte: Per kapacitetin teknik “Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi”, operatori ekonomik Alb Korca 2002 shpk ka paraqitur kontraten e furnizimit nga subjekti “Duro shpk”, date 21.06.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Gjiguria shpk”, rezulton qe subjekti “Duro shpk”, date 11.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate qeraje per kete kapacitet, me afat 3 vjecar cfare verteton faktin qe kontrata e furnizimit eshte e pavlefshme.*

2. *Ne lidhje me deshmitet per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, nga dokumentacioni i paraqitur rezulton te jete kamion dhe jo ATV (APV).*

3. *Formularët E-SIG, rezultojne te jene te pakonfirmuara nga organet perkatese me nenshkrim elektronik ose ne hard copy, ne kundershtrim me piken 2.3.2, te kritereteve te dhene ne DST.*

4. *Nuk ka permbushur sic duhet piken 2.2.3, te kerkesave per kualifikim, pasi nuk ka paraqitur dokument qe vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ne Korce dhe Erseke ku ka ushtruar aktivitetet per vitin 2017.*

II.5. Në datën 01.08.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Për sa i përket arsyes së parë të skualifikimit ne gjykojmë se është e padrejtë për arsye se ne disponojmë një kontratë të rregullt furnizimi dhe ne nuk jemi njoftuar nga subjekti Durro shpk për anulimin e kontratës së furnizimit. Madje objekti i prokurimit për të cilin ankimohemi ka qenë në datën 09.07.2018 dhe kontrata me Gjukurinë dhe Duron gjithmonë sipas jush ka qenë në datën 11.07.2018 e cila është përtej datës së objektit që është prokuruar. Dhe mbetet për tu parë se cila kontratë është e pavlefshme. Ne gjykojmë se kjo pikë nuk qëndron nga AK.*
- *Për sa i përket arsyes së dytë referuar LPP dhe DST ju keni kërkuar Borëpastruese (APV) dhe në mënyrë kategorike nuk keni përmendur dicka sic përmendni për autobitumatricen të jetë APV. Ne kemi paraqitur dokumentacionin përkatës për autobitumatrice sic është Kontratë Shitblerje me nr.450 rep dhe nr.402 kol datë 04.09.2009 dhe deklaratat doganore. Nuk kemi paraqitur asnjë mjet kamion sic ju pretendoni.*
- *Për sa i përket arsyes së tretë ne ju ripërmendim Ligjin për Procedurat Tatimore dhe Sigurimet Shoqërore që nga viti 2013 listpagesat deklarohen onlinedhe nuk konfirmohen më pranë orgneve tatimore. Listpagesat e dorëzuara janë ato që ne kemi shkarkuar nga faqja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ku dhe ju mund të konfirmoni lehtësisht listpagesat.*
- *Për sa i përket arsyes së katërt ju bëjmë me dije se selia e shoqërisë Alb Korca 2002 shpk ndodhet në rrugën nacionale Korçë Bilisht pranë nënstacionit zemblak ku sipas ndarjes së re teritoriale është pjesë e Bashkisë Maliq ku ne nuk kemi asnjë detyrim sic e vërteton dhe vërtetimi që ne kemi paraqitur ne nuk disponojmë adresa të tjera në Ekstraktet e QKB. Vërtet mund të kemi ushtruar aktivitet në Ersekë por jo nuk do të thotë që ne kemi ngritur kantier pranë kësaj bashkie. Punëtorët e shoqërisë Alb Korcca 2002 duke u nisur dhe nga pozicioni gjeografik që Bashkia Kolonjë ka me Bashkinë Maliq dhe Bashkinë Korçë kanë bërë lëvizje ditore duke shkuar paradite dhe në përfundim të punës janë kthyer mbrapsht. Ne kemi paguar të gjitha detyrimet e taksave vendore.*

Referuar LPP ne gjykojmë se arsyet e skualifikimit nuk janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

II.6. Në datën 08.08.2018 me shkresën nr. 533 prot operatori ekonomik ankimues “Alb Korça 2002” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 15.08.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.585 datë 27.08.2018 protokolluar me tonën me nr.1400/2 datë 29.08.2018 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alb Korça 2002” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “ *Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, nga dokumentacioni i paraqitur rezulton te jete kamion dhe jo ATV (APV)*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 pika 2.3.7 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Eskavatore fadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Eskavator me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Kamioncine	në pronësi ose me qira	Copë 2

9	Mjete borepastrues	në pronësi ose me qira	Cope 4
9	Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), certifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / cdoganimi në RSH (ose kalimi me regjim të perkohshëm), fotot dhe fatura tatimore perkatëse.

- Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerave, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqerohen me kuponin tatimor.

- Për sa u përket mjeteve borepastruese duhet të jenë të paisura me kripore dhe thike (ku të komandohen nga brenda kabines nga manovratori) dhe (jo të jenë të improvizuara si mjete borepastruese duke bërë bashkim pjesësh për të improvizuar borepastruese). Për mjetet borepastruese në lejet e qarkullimit të tyre duhet të jete e cilesuar si APV (automjet i përdorimit të vecantë). Mjetet borepastruese duhet të shoqerohen minimalisht me nga dy foto ku të dallohen qartësisht edhe targetet e mjetit dhe pasijet e saj si kryporja dhe thika.

- Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatësisë. Kontratat e qerave duhet të jenë të nënshkrura jo më parë janari viti 2018, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe të deklarohet qartësisht nga qeradhënsi që mjete nuk i është dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër për këtë periudhë.

- Fabrika asfaltobetoni duhet të jete e montuar në gjendje pune dhe të instaluar në një vendodhje jo më larg se 60 km nga objekti (mjafton nga një pike e rrugëve që mirembahen nga Kontrata). Ajo duhet të jete e pajisur me QKL dhe leje mjedisore. Ofertuesi duhet të deklarojë vendndodhjen e saktë të fabrikës së asfaltobetonit të montuar (nuk pranohet deklarate levizje impianti), të paraqesë planin e vendosjes të fabrikës së asfaltobetonit dhe të paraqesë fotografi të fabrikës së asfaltobetonit të montuar në vendndodhjen e deklaruar.

- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

- 2.3.8 *Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.*
- *Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".*

III.1.2. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi janë bërë ndryshimet si më poshtë:

Ishte:

Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *"Kur mjetet / pajisjet teknike jane me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerase, dhe bashkëlidhur te gjithë dokumentet e përshkruar ne paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerase duhet te jene te nenshkruara jo me pare janari viti 2018, te përfshijnë te gjithë periudhën e realizimit te kontrates dhe....."*

Bëhet:

"Kur mjetet / pajisjet teknike jane me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerase, dhe bashkëlidhur te gjithë dokumentet e përshkruar ne paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerase duhet te përfshijnë te gjithë periudhën e realizimit te kontrates dhe....."

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues "Alb Korça 2002" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër në drejtim të vërtetimit të disponueshmërisë së makinerisë *autobitumatrice- copë 1* ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Kontratë Shitblerje Nr.450 Rep, Nr.402 Kol datë 04.03.2009 midis D.G Konstruksion shpk në cilësinë e shitësit dhe Alb Korça 2002 në cilësinë e blerësit me objekt Makinë shpërndarje bitumi*
- *Deklaratë Doganore*
- *Foto*

III.1.4. Referuar kthim përgjigjes nr. 533 prot datë 08.08.2018 drejtuar ankimuesit nga autoriteti kontraktor lidhur me këtë pretendim sqarohet se: *Për kapacitetin teknik autobitumatrice në pronësi ose me qera copë 1 kërkuar në DST nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se operatori ekonomik Alb Korça 2002 shpk nuk ka paraqitur automjetin autobitumatrice por ka paraqitur një pajisje bitumi pa targë, pa leje qarkullimi pa asnjë dokument. Theksojmë se*

autoriteti kontraktor në DST ka kërkuar kapacitetin teknik “Autobitumatrice”, që është një automjet i lëvizshëm me rrota, me motorr i pajisur me një cistrenë bitumi dhe me pajisjet e spërkatjes së bitumit. Spërkatja e bitumit bëhet me komandim automatik nga kabina. Këto janë mjete që shënohen në regjistra publikë dhe duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi) , certifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit. Gjithashtu në fotot e paraqitura nga OE Alb Korça 2002 duket qartë që mjeti nuk është “Autobitumatrice” por një pajisje e thjeshtë bitumi. Kjo pajisje nuk plotëson asnjë nga kushtet e kërkuara në specifikimet teknike pjesë e DT. Pra mosplotësimi i këtij kriteri ka për pasojë dështimin e OE për realizimin e kontratës. Për sa më sipër pretendimet e subjektit ankimes edhe për këtë kriter nuk qëndrojnë.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa referuar nenit 53, pika 3 parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.1.6. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantëtë kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar kapacitetin teknik “Autobitumatrice” një copë. Gjithashtu në kriter kërkohet shprehimisht se për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), certifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Alb Korça 2002” shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kapaciteti ankimesi ka parqitur një kontratë shitblerje me objekt “Makinë shpërndarje bitumi”, deklaratë doganore, si dhe foto të mjetit, nga e cila rezulton se është paraqitur një pajisje pa targa dhe pa rrota si dhe rezulton se për të nuk është dorëzuar asnjë nga dokumentet e kërkuar në dokumentet e tenderit si leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policë e sigurimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë ofertën në përputhje me dokumentet e tenderit dhe kërkesat e autoritetit kontraktor. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimesi nuk ka provuar se disponon në pronësi, apo me qira një mjet autobitumatriçe për plotësimin e kriterit të veçantë të kualifikimit.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimesi mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimesi “Alb Korça 2002” sh.p.k nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Alb Korça 2002” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-73808-06-06-2018 me objekt “*Mirembajtje Rutine E Dimerore Me Performance Rruga Libonik-Lozhan-Grabove + Rruga Lin-Pogradec + Rruga Voskop-Voskopoje 72 Km*” me fond limit 40,030,784 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1400 Protokolli; Datë 15.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha